

LIGJ
Nr. 43/2024

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT, PËR LIGJIN E ZBATUESHËM
PËR DETYRIMET USHQIMORE**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollin për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore, bërë në Hagë, më 23 nëntor 2007, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ligji nr. 10 397, datë 17.3.2011, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ‘Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore’”, shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.5.2024.

Shpallur me dekreten nr. 180, datë 20.5.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

PROTOKOLL
PËR LIGJIN E ZBATUESHËM PËR DETYRIMET USHQIMORE¹
(lidhur më 23 nëntor 2007)

Shtetet nënshkrues të këtij Protokollit,
me dëshirën për të vendosur dispozita të përbashkëta, në lidhje me ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore;

me dëshirën për të rinovuar këto dispozita dhe ato të Konventës së Hagës, të 24 tetorit 1956, mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore ndaj fëmijëve dhe *Konventës së Hagës, të 2 tetorit 1973, për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore;*

me dëshirën për të hartuar rregulla të përgjithshme, në lidhje me ligjin e zbatueshëm që mund të plotësojë *Konventën e Hagës së 23 nëntorit 2007, për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijës dhe për pjesëtarët e tjerë të familjes,*

kanë vendosur të lidhin këtë Protokoll për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

¹ Ky Protokoll, duke përfshirë materialet e ngjashme, është i aksesueshëm në faqen e internetit të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (www.hcch.net) sipas “Konventave”. Për historikun e plotë të Protokollit, shihni Konferencën e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, Procedurat e Sesionit të Njëzet e Njëte [për publikim].

Neni 1
Fusha e zbatimit

1. Ky Protokoll përcakton ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore që rrjedhin nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesore apo lidhje tjetër jोगiaku, duke përfshirë edhe një detyrim ushqimor ndaj një të mituri, pavarësisht gjendjes civile të prindërve.

2. Vendimet e dhëna në zbatim të këtij Protokoll nuk cenojnë ekzistencën e ndonjë prej marrëdhënieve të referuara në paragrafin 1.

Neni 2
Zbatimi universal

Ky Protokoll zbatohet edhe nëse ligji i zbatueshëm është ai i një shteti jokontraktues.

Neni 3
Rregulli i përgjithshëm i ligjit të zbatueshëm

1. Detyrimet ushqimore rregullohen nga ligji i shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm të përfituesit të detyrimit ushqimor, përveç rasteve kur ky Protokoll parashikon ndryshe.

2. Në rast të një ndryshimi të vendqëndrimit të zakonshëm të përfituesit të detyrimit ushqimor, ligji i shtetit të vendqëndrimit të ri të zakonshëm zbatohet që nga momenti kur ndodh ndryshimi.

Neni 4
Rregulla të veçanta favorizuese ndaj disa përfituesve të detyrimit ushqimor

1. Dispozitat e mëposhtme zbatohen në rastin e detyrimeve ushqimore, të:

- a) prindërve ndaj fëmijëve të tyre;
- b) personave të tjerë, përveç prindërve, ndaj personave që nuk kanë arritur moshën 21 vjeç, përveç detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhëniet e referuara në nenin 5; dhe
- c) fëmijëve ndaj prindërve të tyre.

2. Ligji *lex fori* zbatohet nëse përfituesi i detyrimit ushqimor nuk është në gjendje, në bazë të ligjit të referuar në nenin 3, për të përfituar detyrimin ushqimor nga ofruesi i këtij detyrimi.

3. Pavarësisht nenit 3, ligji *lex fori* zbatohet nëse përfituesi i detyrimit ushqimor i është drejtuar autoritetit kompetent të shtetit, ku ofruesi i këtij detyrimi ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm. Megjithatë, nëse përfituesi i detyrimit ushqimor nuk është në gjendje, në bazë të këtij ligji, për të përfituar detyrimin ushqimor nga ofruesi i këtij detyrimi, zbatohet ligji i shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm të përfituesit të detyrimit ushqimor.

4. Nëse përfituesi i detyrimit ushqimor nuk është në gjendje, në bazë të ligjeve të referuara në nenin 3, dhe paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, për të përfituar detyrimin ushqimor nga ofruesi i këtij detyrimi, zbatohet ligji i shtetësisë së tyre të përbashkët, nëse ka.

Neni 5
Rregulli i veçantë në lidhje me bashkëshortët dhe ish-bashkëshortët

Në rastin e një detyrimi ushqimor ndërmjet bashkëshortëve, ish-bashkëshortëve apo palëve në një martesë të anuluar, neni 3 nuk zbatohet, nëse një nga palët kundërshton dhe nëse ligji i një shteti tjetër, veçanërisht i shtetit të vendqëndrimit të tyre të fundit të zakonshëm ka një lidhje më të afërt me martesën. Në këtë rast zbatohet ligji i atij shteti tjetër.

Neni 6
Rregulli i veçantë për mbrojtjen

Në rastin e një detyrimi ushqimor, përveç detyrimit që rrjedh nga marrëdhënia prind–fëmijë ndaj një fëmije dhe marrëdhënieve të referuara në nenin 5, ofruesi i detyrimit ushqimor mund të kundërshtojë një kërkesë nga përfituesi i këtij detyrimi, mbi bazën që nuk ka asnjë detyrim të tillë sipas ligjit të brendshëm të vendqëndrimit të zakonshëm të ofruesit të detyrimit ushqimor, si edhe sipas ligjit të shtetësisë së tyre të përbashkët, nëse ka.

Neni 7

Përcaktimi i ligjit të zbatueshëm për qëllim të një procedure të veçantë

1. Pavarësisht neneve 3 deri 6, vetëm për qëllim të një procedure të veçantë në një shtet të caktuar, përfituesi dhe ofruesi i detyrimit ushqimor mund të përcaktojnë shprehimisht ligjin e atij shteti si ligjin e zbatueshëm për një detyrim ushqimor.

2. Përcaktimi i ligjit para fillimit të kësaj procedure bëhet me marrëveshje me shkrim ose të dokumentuar në çdo lloj mënyre tjetër, të nënshkruar nga të dyja palët, dhe informacioni i së cilës është i aksesueshëm për t'u përdorur më pas si referim.

Neni 8

Përcaktimi i ligjit të zbatueshëm

1. Pavarësisht neneve 3 deri 6, përfituesi dhe ofruesi i detyrimit ushqimor mund të përcaktojnë në çdo kohë një nga ligjet e mëposhtme si ligjin e zbatueshëm për detyrimin ushqimor:

- a) ligjin e çdo shteti ku njëra nga palët është shtetase në momentin e përcaktimit;
- b) ligjin e shtetit ku njëra nga palët ka vendqëndrimin e zakonshëm në momentin e përcaktimit;
- c) ligjin e përcaktuar nga palët si të zbatueshëm ose ligjin që zbatohet ndaj regjimit pasuror martesor;
- d) ligjin e përcaktuar nga palët si të zbatueshëm ose ligjin që zbatohet gjatë divorcit, ose ndarjes së tyre ligjore.

2. Kjo marrëveshje bëhet me shkrim ose e dokumentuar në çdo lloj mënyre tjetër, informacioni i së cilës është i aksesueshëm për t'u përdorur më pas si referim, dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

3. Paragrafi 1 nuk zbatohet për detyrimet ushqimore, në lidhje me një person nën moshën 18 vjeç apo për një person madhor, i cili për shkak të ndonjë kufizimi apo mangësie të aftësive të tij/saj personale, nuk është në gjendje të mbrojë interesin e tij ose të saj.

4. Pavarësisht ligjit të përcaktuar nga palët në përputhje me paragrafin 1, çështja e heqjes dorë ose jo nga e drejta e detyrimit ushqimor nga ana e përfituesit përcaktohet nga ligji i shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm të përfituesit të detyrimit ushqimor në momentin e përcaktimit.

5. Nëse në kohën kur është bërë përcaktimi i ligjit, palët nuk janë informuar plotësisht dhe nuk janë të ndërgjegjshme për pasojat e këtij përcaktimi, ligji i përcaktuar nga palët nuk zbatohet, nëse zbatimi i tij do të sillte pasoja haptazi të padrejta dhe të paarsyeshme për ndonjë nga palët.

Neni 9

“Vendbanim” në vend të “kombësisë”

Për qëllim të çështjeve që paraqiten para autoriteteve të tij, një shtet i cili ka konceptin e “vendqëndrimit” si faktor lidhës në çështjet familjare, mund të informojë Zyrën e Përhershme të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, se fjala “shtetësi”, në nenet 4 dhe 6, zëvendësohet me “vendqëndrim”, siç përcaktohet në atë shtet.

Neni 10

Organet publike

E drejta e një organi publik për të marrë rimbursimin e një përfitimi të parashikuar për përfituesin e detyrimit ushqimor, rregullohet nga ligji të cilit i nënshtrohet organi publik.

Neni 11

Fusha e veprimit e ligjit të zbatueshëm

Ligji i zbatueshëm për një detyrim ushqimor përcakton ndër të tjera:

- a) nëse, në cilën masë dhe ndaj kujt një përfitues mund të pretendojë detyrimin ushqimor;
- b) në cilën masë një përfitues mund të pretendojë detyrimin ushqimor me efekt prapaveprues;
- c) bazën mbi të cilat llogaritet shuma e detyrimit ushqimor dhe indeksimi;
- d) cili gëzon të drejtën e fillimit të procedurave për detyrim ushqimor, me përjashtim të çështjeve në lidhje me zotësinë procedurale dhe përfaqësimin në procedurë;
- e) parashkrimin ose periudhat e parashkrimit;
- f) masën e detyrimit të ofruesit të detyrimit ushqimor, kur një organ publik kërkon rimbursimin e përfitimeve të parashikuara për përfituesin e detyrimit, në vend të detyrimit ushqimor.

Neni 12

Përjashtimi i *renvoi* (referimit ndaj juridiksionit të një shteti tjetër)

Në Protokoll, termi “ligj” nënkupton ligjin në fuqi të një shteti, me përjashtim të rregullave të zgjedhjes së ligjit.

Neni 13

Politika publike

Zbatimi i ligjit të përcaktuar sipas Protokollit, mund të refuzohet vetëm në masën që pasojat e tij do të ishin haptazi në kundërshtim me politikën publike të vendqëndrimit.

Neni 14

Përcaktimi i shumës së detyrimit ushqimor

Edhe nëse ligji i zbatueshëm e parashikon ndryshe, nevojat e përfituesit të detyrimit ushqimor dhe burimet e ofruesit të këtij detyrimi, si edhe çfarëdolloj kompensimi që përfituesit i jepet në vend të pagesave periodike të detyrimit ushqimor, do të merren parasysh në përcaktimin e shumës së detyrimit ushqimor.

Neni 15

Moszbatimi i Protokollit për konflikte të brendshme

1. Një shtet kontraktues në të cilin zbatohen sisteme të ndryshme ligjore ose grupe rregullash të ndryshme ligjore për detyrimet ushqimore, nuk është i detyruar të zbatojë rregullat e Protokollit për konfliktet e ligjit të lidhura vetëm me këto sisteme apo grupe të ndryshme rregullash ligjore.

2. Ky nen nuk zbatohet për një organizatë rajonale të integritetit ekonomik.

Neni 16

Sistemet ligjore të paunifikuara – territoriale

1. Në një shtet brenda të cilit njësi të ndryshme territoriale zbatojnë dy apo më shumë sisteme ligjore apo grupe rregullash ligjore, në lidhje me ndonjë çështje të parashikuar në këtë Protokoll:

- a) çdo referim në ligjin e një shteti interpretohet, sipas rastit, si referim në ligjin në fuqi të njësisë territoriale përkatëse;
- b) çdo referim për autoritetet kompetente ose organet publike të atij shteti interpretohet, sipas rastit, si referim për personat e autorizuar për të vepruar në njësinë përkatëse territoriale;
- c) çdo referim për vendqëndrimin e zakonshëm në atë shtet interpretohet, sipas rastit, si referim për vendqëndrimin e tij të zakonshëm në njësinë përkatëse territoriale;

d) çdo referim për shtetin ku të dy personat kanë shtetësi të përbashkët interpretohet si referim për njësinë territoriale të përcaktuar me ligjin e atij shteti ose nëse nuk ka rregulla të tilla, për njësinë territoriale me të cilën detyrimi ushqimor është i lidhur më ngushtë;

e) çdo referim për shtetin ku një person është shtetas, interpretohet si referim për njësinë territoriale të përcaktuar me ligjin e atij shteti ose, nëse nuk ka rregulla të tilla, për njësinë territoriale me të cilën personi është i lidhur më ngushtë.

2. Me qëllim identifikimin e ligjit të zbatueshëm sipas Protokollit, në lidhje me një shtet, brenda të cilit ka dy ose më shumë njësi territoriale me sistemet e veta ligjore apo me grupe të ndryshme rregullash ligjore, në lidhje me çështjet e rregulluara nga ky Protokoll, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) nëse në këtë shtet ka rregulla në fuqi që identifikojnë se ligji i cilës njësi territoriale është i zbatueshëm, zbatohet ligji i asaj njësie;

b) nëse nuk ka rregulla të tilla, zbatohet ligji i njësisë territoriale përkatëse, siç parashikohet në paragrafin 1.

3. Ky nen nuk zbatohet për një organizatë rajonale të integritetit ekonomik.

Neni 17

Sisteme ligjore të paunifikuara – konflikte ndërpersonale

Me qëllim identifikimin e ligjit të zbatueshëm sipas Protokollit, në lidhje me një shtet brenda të cilit ka dy ose më shumë njësi territoriale me sistemet e veta ligjore apo me grupe të ndryshme rregullash ligjore të zbatueshme për kategori të ndryshme personash, në lidhje me çështjet e rregulluara nga ky Protokoll, çdo referim për ligjin e këtij shteti interpretohet si referim për sistemin ligjor të përcaktuar nga rregullat në fuqi në atë shtet.

Neni 18

Bashkërendimi me konventat e mëparshme të Hagës për detyrimin ushqimor

Ky Protokoll zëvendëson, në marrëdhëniet midis shteteve që janë palë në të, Konventën e Hagës së 2 tetorit 1973, mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore dhe Konventën e Hagës së 24 tetorit 1956, mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore ndaj fëmijëve.

Neni 19

Bashkërendimi me instrumente të tjera

1. Ky Protokoll nuk cenon ndonjë instrument tjetër ndërkombëtar që përmban dispozita për çështje që rregullohen nga ky Protokoll, në të cilin shtetet kontraktuese janë ose bëhen palë, vetëm nëse deklarohet ndryshe nga shtetet palë të këtij instrumenti.

2. Pika 1 zbatohet edhe për ligjet uniforme në bazë të lidhjeve të veçanta rajonale apo të ndonjë natyre tjetër ndërmjet shteteve në fjalë.

Neni 20

Interpretimi uniform

Në interpretimin e këtij Protokollit, i kushtohet vëmendje natyrës së tij ndërkombëtare dhe nevojës për të nxitur zbatimin e tij uniform.

Neni 21

Shqyrtimi i funksionimit praktik të Protokollit

1. Sekretari i Përgjithshëm i Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private mbledh një Komision të Posaçëm, nëse e nevojshme, për të shqyrtuar funksionimin praktik të Protokollit.

2. Për qëllim të këtij shqyrtimi, shtetet kontraktuese bashkëpunojnë me Zyrën e Përhershme të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private për mbledhjen e praktikës ligjore, në lidhje me zbatimin e Protokollit.

Neni 22

Dispozita kalimtare

Ky Protokoll nuk zbatohet për detyrimin ushqimor të pretenduar në një shtet kontraktues që lidhet me periudhën para hyrjes në fuqi të Protokollit në atë shtet.

Neni 23

Nënshkrimi, ratifikimi dhe aderimi

1. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet.
2. Ky Protokoll i nënshtrohet ratifikimit, pranimit apo miratimit nga shtetet nënshkruese.
3. Ky Protokoll është i hapur për aderim nga të gjitha shtetet.
4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit depozitohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës, depozitari i Protokollit.

Neni 24

Organizatat rajonale të integritit ekonomik

1. Një organizatë rajonale e integritit ekonomik e themeluar vetëm nga shtete sovrane dhe që ka kompetencë për disa ose të gjitha çështjet e rregulluara nga Protokollit, gjithashtu, mund të nënshkruajë, pranojë, miratojë ose aderojë në Protokoll. Në këtë rast, organizata rajonale e integritit ekonomik ka të drejtat dhe detyrimet e një shteti kontraktues, në atë masë që organizata ka kompetencë për çështjet e rregulluara në Protokoll.

2. Në kohën e nënshkrimit, pranimit, miratimit apo aderimit, organizata rajonale e integritit ekonomik njofton depozitarin, me shkrim, për çështjet e rregulluara nga Protokollit, në lidhje me kompetencën që i është transferuar organizatës nga shtetet anëtare. Organizata njofton me shkrim menjëherë depozitarin për ndonjë ndryshim të kompetencës së saj, siç përcaktohet në njoftimin më të fundit që organizata kryen, sipas këtij paragrafi.

3. Në kohën e nënshkrimit, pranimit, miratimit apo aderimit, një organizatë rajonale e integritit ekonomik, në përputhje me nenin 28, mund të deklarojë se ushtron kompetencën e saj për të gjitha çështjet e rregulluara nga Protokollit dhe shtetet anëtare, të cilat i kanë transferuar organizatës rajonale të integritit ekonomik kompetencën për çështjen në fjalë, janë të detyruara nga Protokollit nëpërmjet nënshkrimit, pranimit, miratimit apo aderimit të organizatës.

4. Për qëllime të hyrjes në fuqi të Protokollit, çdo instrument i depozituar tek organizata rajonale e integritit ekonomik nuk do të merret parasysh, nëse organizata rajonale e integritit ekonomik nuk bën një deklaratë sipas paragrafit 3.

5. Çdo referim për një “Shtet kontraktues” apo “Shtet” në Protokoll zbatohet, sipas rastit, edhe për organizatën rajonale të integritit ekonomik në të cilën është palë. Në rastin kur bëhet një deklaratë nga organizata e integritit ekonomik rajonal sipas paragrafit 3, çdo referim për “Shtetin kontraktues” apo “Shtetin” në Protokoll zbatohet, sipas rastit, njëloj për shtetet anëtare të organizatës.

Neni 25

Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe prej tre muajsh pas depozitimit të instrumentit të dytë të ratifikimit, pranimit ose miratimit të referuar në nenin 23.

2. Pas kësaj, Protokollit hyn në fuqi:

a) për çdo shtet apo çdo organizatë rajonale të integritit ekonomik të referuar në nenin 24, që më pas e ratifikon, pranon ose miraton Protokollin apo aderon në të, në ditën e parë të muajit pas përfundimit

të një periudhe prej tre muajsh pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;

b) për njësinë territoriale në të cilin Protokollu ka shtrirë veprimin, në përputhje me nenin 26, në ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe prej tre muajsh pas njoftimit të deklaratës së referuar në atë nen.

Neni 26

Deklaratat në lidhje me sisteme ligjore të paunifikuara

1. Një shtet që ka dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në çështjet e trajtuara në këtë Protokoll, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit deklaron, në përputhje me nenin 28, se ky Protokoll shtrin veprimin në të gjitha njësitë e tij territoriale apo vetëm në një ose më shumë prej tyre dhe mund të ndryshojë deklaratën e tij, duke paraqitur një deklaratë tjetër në çdo kohë.

2. Një deklaratë e tillë i njoftohet depozitarit dhe shprehin shprehimisht njësinë territoriale në të cilën zbatohet Protokollu.

3. Nëse një shtet nuk deklaron në përputhje me këtë nen, Protokollu do të shtrijë veprimin e tij në të gjitha njësitë territoriale të atij shteti.

4. Ky nen nuk zbatohet për një organizatë rajonale të integritetit ekonomik.

Neni 27

Rezervat

Në këtë Protokoll nuk mund të bëhet asnjë rezervë.

Neni 28

Deklaratat

1. Deklaratat e referuara në nenet 24 (3) dhe 26 (1) mund të bëhen me nënshkrimin, ratifikimin, pranimin, miratimin apo aderimin ose në çdo kohë pas kësaj dhe mund të modifikohen ose tërhiqen në çdo kohë.

2. Deklaratat, modifikimet dhe tërheqjet i njoftohen depozitarit.

3. Një deklaratë e bërë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit hyn në fuqi në të njëjtën kohë me hyrjen në fuqi të këtij Protokollu për shtetin përkatës.

4. Një deklaratë e bërë më vonë, si edhe çdo modifikim ose tërheqje e një deklarate, hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe prej tre muajsh, pas datës kur njoftimi merret nga depozitari.

Neni 29

Denoncimi

1. Një shtet kontraktues në këtë Protokoll mund ta denoncojë atë me një njoftim me shkrim drejtuar depozitarit. Denoncimi mund të kufizohet në njësi të caktuara territoriale të një shteti me sistem ligjor të paunifikuar për të cilin zbatohet Protokollu.

2. Denoncimi hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës prej 12 muajsh, pas datës kur njoftimi merret nga depozitari. Nëse njoftimi përcakton një periudhë më të gjatë kohore për hyrjen në fuqi të denoncimit, ai hyn në fuqi pas përfundimit të kësaj periudhe, pas datës kur njoftimi është marrë nga depozitari.

Neni 30

Njoftimi

Depozitari njofton shtetet anëtare të Konferencës së Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private, edhe shtetet e tjera, si edhe organizatat rajonale të integritimit ekonomik që kanë nënshkruar, ratifikuar, pranuar, miratuar apo aderuar, në përputhje me nenin 23, për sa më poshtë:

- a) nënshkrimet dhe ratifikimet, pranimet, miratimet dhe aderimet e referuara në nenet 23 dhe 24;
- b) datën kur ky Protokoll hyn në fuqi, në përputhje me nenin 25;
- c) deklaratat e referuara në nenin 24 (3) dhe 26 (1);
- d) denoncimet e referuara në nenin 29.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Hagë, në datën 23 nëntor 2007, në gjuhët angleze dhe franceze, ku të dyja tekstet janë njëloj të barasvlershme, në një kopje të vetme që depozitohet në arkivat e qeverisë së Holandës dhe nga të cilat një kopje e vërtetuar i dërgohet, nëpërmjet rrugëve diplomatike, secilit prej shteteve anëtare të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, në datën e sesionit të njëzetë e një të saj dhe secilit prej shteteve të tjera që kanë marrë pjesë në atë sesion.